



Planuar / Dorezuar Prijemno/Prilazno Received / Delivny	19.05.2021	viti god year	
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMS/ICK	2485/2021		114



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.286/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Valentina Kaçandolli Bekteshi-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, sipas Aktgjykimit A.Nr.2250/19 të datës 12.04.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.263/2019 të datës 02.05.2019, të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi Rr."Borshi", Nr.6, Prishtinë, kundër organit të punësimit Njësia për Inteligjencë Financiare, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 19.05.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.263/2019 e datës 02.05.2019 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi zyrtar në Njësinë e Inteligjencës Financiare, me datë 02.05.2019 ka parashtruar ankesë me numër të protokollit 2107/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendim ankimor për kompensimin e të gjitha mjeteve financiare, që nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënies së punës nga data 26.08.2011 deri më 17.08.2017, kur ka nënshkruar Aktpajtimin me Njësinë e Inteligjencës Financiare, për kthim e tij në punë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 07.05.2019 përmes shkresës me numër protokollit 2176/2019 ka proceduar kërkesën për përgjigjen në ankesën e ankuesit tek Njësia e Inteligjencës Financiare. Ndërsa më datë 16.05.2019 Njësia për

Inteligjencë Financiare ka përcjellë përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020, ka qenë jo funksional për shkak të mungesës kuorumit, me ç'arsye Këshilli me datë 21.06.20219 ka njoftuar ankuesin për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës së tij me numër A.nr.263/2019 të datës 02.05.2019, duke udhëzuar të njëjtin për të drejtën e ndjekjes së procedurës gjyqësore në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ. Pas këtij njoftimi të Këshillit, ankuesi ka hapur konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, e cila me Aktgjykimin A.nr.2250/19 të datës 12.04.2021 i pranuar në Këshill me datë 19.04.2021 ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke ka anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 22.08.2019 dhe ka detyruar Këshillin të vendos për ankesën e ankuesit të datës 02.05.2019.

Kolegji për vërtetimin e drejtë dhe plotë të gjendjes faktike si dhe vendosje të drejtë të çështjes, ka administruar këto prova: Njoftimi nga ankuesi për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 30.04.2021; Vendimi A 02/232/2011 i datës 18.11.2011 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës; Urdhri për përmbarrim E.nr.1827/13 i Gjykatës Themelore në Prishtinë; Aktgjykimi i datës 12.04.2021 i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Ankesa e ankuesit e datës 02.05.2019 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Aktpajtimi i datës 17.08.2017; Njoftimi i datës 02.08.2017; Urdhri për përmbarrim E.nr.1827/13 i Gjykatës Themelore në Prishtinë; Aktvendimi AC.nr.1339/2016 i Gjykatës së Apelit të Kosovës i datës 20.04.2017; Vendimi A/02/371/2013/R i datës 11.11.2013 i Këshillit i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigja në kërkesën për sqarim të dispozitave të Vendimit A 02/371/2013/R për ankuesin nga Udhëheqësi i Divizionit për Mbështetje Profesionale i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i datës 20.11.2017; Aktgjykimi i datës 14.01.2016 me numër A.nr.1628/2013 i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit e Kosovës A.A.nr.84/2016 i datës 26.04.2016; Ankesa e ankuesit e datës 18.03.2019 e parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Njësisë së Inteligjencës Financiare; Përgjigja e datës 04.04.2019 e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Njësisë së Inteligjencës Financiare; Akt emërimi i ankuesit me FIUAD Nr.165/2017; Përshkrimi i detyrave të punës; Dorëzimi-pranimi i formularëve në sektorin e listë-pagesave; Lista e pagave e datës 01.10.2017; 01.09.2017; Evidenca e pushimeve vjetore, mjekësore etj; Aktvendimi për provueshmërinë në rastin nr.KI83/17 i Gjykatës Kushtetuese si dhe përgjigja në ankesë nga organi i punësimit i datës 16.05.2019.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit *refuzohet si e pa bazuar, sepse:*

Lidhur me pranueshmërinë e ankesës Kolegji ka analizuar Ligjin Nr.05/L-096 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit, përkatësisht nenin 4 paragrafi 3 më të cilin është përcaktuar se: *Stafi profesional i NjIF-K nuk janë nëpunës civil. Megjithatë legjislacioni që rregullon çështjet e shërbimit civil zbatohet ndaj stafit të NjIF-K, përveç*

rasteve kur rregullohet ndryshe me këtë ligj dhe aktet tjera nënligjore të cilat do të jenë në pajtueshmëri me parimet themelore të shërbimit civil, dhe si rrjedhojë ka konstatuar se dispozitat e legjislacionit të shërbimit civil zbatohen në raport edhe me zyrtaret profesional të Njesisë së Inteligjencës Financiar, Andaj, në këtë kuptim Kolegji ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit sipas A.nr.263/2021 të datës 05.02.2019.

Bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji ka gjetur se ankuesi dhe Njësia për Inteligjencës Financiare, pas Vendimit të Gjykatës së Apelit AC.nr.1339/2016 të datës 20.04.2017 dhe Urdhrit për Përmbarrim të Gjykatës Themelore në Prishtinë E.nr.1827/2013 të datës 13.07.2017 për përmbarrim të Vendimit të KPMSHCK-së me numër A.nr.02/371/2013 të datës 11.11.2013, me datë 17.08.2017 kanë lidhë Akt Pajtim për sistemimin e ankuesit në pozitën e Analistit të Inteligjencës.

Ankuesi me datë 15.11.2017 ka parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kërkesën për sqarim të dispozitivit të Vendimit A.02/371/2013/R të datës 11.11.2013, ndërsa Këshilli me datë 20.11.2017 përmes shkresës numër protokolli 6026/2017 ka njoftuar ankuesin lidhur me të drejtat dhe detyrimet e Njesisë së Inteligjencës Financiare sipas Vendimit të Këshillit A.02/371/2013/R të datës 11.11.2013.

Ankuesi me datë 18.03.2019 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Njesisë së Inteligjencës Financiare, me pretendim ankimor për kompensimin e të gjithave mjeteve financiare që nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënies së punës nga data 06.08.2011 deri më datë 17.08.2017, kur është zbatuar vendimi i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Njesisë së Inteligjencës Financiare me Përgjigjen nr. Reference FIUAD:75/2019 me datë 04.04.2019, ka informuar ankuesin se *"Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të NjIF-K vlerëson se nuk ka kompetencë për trajtimin e saj, pasi që lidhur me këtë kërkesë është vendosur në instanca më të larta administrative dhe gjyqësore"*.

Ankuesi me datë 02.05.2019, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendim ankimor për kompensimin e të gjitha mjeteve financiare, që nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënies së punës nga data 26.08.2011 deri më 17.08.2017, kur ka nënshkruar Aktpajtimin me Njësinë e Inteligjencës Financiare, për kthim në punë, ndërsa me 30.04.2021 ka bërë precizimin e ankesës të datës 02.05.2019, me pretendim për kthimin e tij në pozitë udhëheqëse dhe ti kompensohen të gjitha beneficionet që rrjedhin nga marrëdhënia e punës, në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi të financave publike, duke përfshirë pagat dhe pushimin vjetor të pashfrytëzuar.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, bazuar në nenin 50 paragrafi 1 dhe nenin 81 paragrafi 2 nen paragrafi 2.2 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil, ka konstatuar se nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil. Ndërsa Ligji Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, neni 127 përcakton se: *1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda*

tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ; 2. Ankesa kundrejt lëshjes administrative mund të parashitrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ, si dhe Neni 8 paragrafi 2 i Rregullores Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave, ku është përcaktuar se: **Ankesa duhet të paraqitet brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga momenti kur nëpunësi civil konsideron se i janë shkelur të drejtat e tij nga marrëdhënia e punës.**

Andaj, duke u bazuar në shkresat e lëndës, respektivisht në Aktpajtimin e datës 17.08.2017 si dhe shkresën sqaruese të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 20.11.2017 lidhur me zbatimin e Vendimit me numër A. 02/371/2013/R të datës 11.11.2013, Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave vlerëson se ushtrimi i ankesës me datë 18.03.2019 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Njesisë së Inteligjencës Financiare është bërë jashtë afatit ligjor të përcaktuar me dispozitat e lartë cekura.

Kështu që, duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nen paragrafi 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ky vendim hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.286/2021

Valentina Kadardolli BEKTESHI

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Njesisë për Inteligjencës Financiare;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të Njesisë për Inteligjencë Financiare dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

